# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6637
E enjte, 23 qershor 2022
çmimi 0.40 €


## Liberalizimi i vizave për Kosovën, në margjinat e Samitit të BE-së

FAQE 5





Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


# KURTI THOTË NUK I KA NDRYSHUAR QËNDRIMET, OPOZITA E QUAN MASHTRUES

FAQE 4-5



Kryeministri Albin Kurti të mërkurën është përballur në seancën e Kuvendit me deputetët e opozitës për marrëveshjen e arritur për energjinë me Serbinë. Deputetët e opozitës e kanë quajtur mashtrues pasi, sipas tyre, për vite të tëra Kurti të tjerët i kishte shpallur tradhtarë në raport me këtë marrëveshje. Sipas opozitës, tash, me ardhjen në pushtet, Kurti i ka ndryshuar qëndrimet. Me konstatimet e opozitës nuk është pajtuar kryeministri Kurti, duke theksuar se nuk ka ndryshuar as qëllime dhe as qëndrime, por e ka gjetur Kosovën në baltë



## KOSOVA SHËNON RRITJE TË RASTEVE ME COVID

Sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK), në ditët e fundit është shënuar rritje e rasteve me Covid-19. Në 24 orët e fundit, pas 275 testimeve, 43 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me këtë virus FAQE 7

## QEVERIA MERR VENDIM PËR RREGULLIMIN E ÇMIMIT TË NAFTËS

FAQE 7



## AKTUALE



### SCHOLZ: UKRAINA DHE RUSIA ENDE LARG NEGOCIATAVE TË PAQES F. 2

### OSMANI NË BRUKSEL: MBËSHTETJA NGA PARLAMENTI EVROPIAN, GARANCI PËR RRUGËN EVROPIANE TË KOSOVËS F. 3

### RESHJET E MËDHA TË SHIUT DHE BRESHËRI DËMTUAN TË MBJELLAT E FERMERËVE LLAPJANË F. 6

## EKONOMI



### AKP-ja HAP SHPALLJEN PËR QIRADHËNIE TË ASETEVE ATRAKTIVE NË DISA KOMUNA F. 8

### ZRRE-ja TË PREMTEN SHQYRTON KËRKESËN PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR 'ELEKTROSEVERIN' F. 8

## SPORT



### KOSOVA, NIKOQIRE E KUPËS SË BOTËS PËR UNIVERSITETE F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# Scholz: Ukraina dhe Rusia, ende larg negociatave të paqes



**Berlin, 22 qershor** - Ukraina dhe Rusia janë shumë larg përfundimit të luftës përmes negociatave, tha të mërkurën kancelari gjerman Olaf Scholz, duke shtuar se presidenti Vladimir Putin ende beson gabimisht se ai mund t'i diktojë kushtet e paqes. "E vërteta është se ne jemi larg negociatave midis Ukrainës dhe Rusisë, sepse Putini ende beson në mundësinë e një paqeje të diktuar", tha Scholz në një fjalim para ligjvënësve gjermanë.

Scholz, po ashtu, tha të mërkurën se partnerët e NATO-s në Evropën Lindore mund të mbështeten te Gjermania, pasi ajo po ripajis ushtrinë e saj në mënyrë që të mund t'i mbrojë aleatët si dhe veten kundër të gjitha sulmeve të ardhshme. "Në krizën më të madhe të sigurisë në Evropë për dekada, Gjermania - ekonomia më e madhe e BE-së dhe vendi më i populluar - po merr një përgjegjësi shumë të veçantë", tha Scholz në një fjalim në parlament për samitet e ardhshme të Bashkimit Evropian, G7 dhe NATO-s. "Dhe jo vetëm për sigurinë e saj, por edhe për sigurinë e aleatëve të saj", tha ai.

Lufta në Ukrainë nisi më 24 shkurt 2022 me një sulm të paprovokuar të Rusisë.

Ky sulm u pasua me sanksione të ashpra ndaj Rusisë, të cilat, megjithatë, nuk e kanë detyruar Rusinë t'i ndalë sulmet.

# Turqia dhe Rusia arrijnë marrëveshje mbi eksportin e grurit ukrainas

**Ankara, 22 qershor** - Një delegacion turk udhëtoi për në Moskë të mërkurën e 22 qershorit për të biseduar mbi mundësinë e rifillimit të eksporteve të grurit nga Ukraina përgjatë Detit të Zi.

Në takimin që zgjati disa orë në Moskë, përfaqësuesit nga Ministria e Mbrojtjes e Turqisë dhe e Rusisë arritën një marrëveshje për bashkëpunimin e mëtejshëm për kalimin e sigurt të anijeve tregtare turke dhe eksportin e grurit nga portet ukrainase në Detin e Zi.



Miliona tonë grurë dhe drithëra të tjera janë bllokuar prej muajsh në portet e Ukrainës që nga nisja e pushtimit rus, duke sjell shqetësime mbi krizën dhe rritjen e çmimeve në të gjithë botën. "Palët diskutuan për daljen e sigurt të anijeve tregtare turke dhe eksportin e grurit nga portet e Ukrainës, po ashtu edhe mbi lundrimin e sigurt në Detin e Zi", thuhet në deklaratën e Ministrisë ruse pas takimit të së mërkurës.

Rusia ka mohuar në mënyrë të përsëritur bllokimin e kalimit të anijeve me grurë ukrainas, duke fajësuar sanksionet perëndimore për shkak të krizës ushqimore.

Turqia, e cila ka mbajtur marrëdhënie të mira me Moskën dhe Kievin, ka ofruar ta mundësojë kalimin e anijeve nga Ukraina bazuar në një plan të OKB-së që do të garantonte korridore të sigurta në Detin e Zi.

Të mërkurën një anije mallrash e Turqisë u largua nga porti i Mariupolit, qytetit ukrainas të pushtuar nga Rusia, pas një raundi bisedimesh "konstruktive" me Moskën, thuhet në deklaratën e Ministrisë së Mbrojtjes të Turqisë, pa specifikuar nëse po transportonte grurë. "Takimi në Moskë dha rezultatin e tij të parë konkret", tha Ministria e Mbrojtjes e Turqisë në një deklaratë. "Vetëm pak orë pas përfundimit të takimit, anija turke e mallrave të thata, e cila priste prej ditësh, u largua nga porti ukrainas".

Në deklaratë u bë me dije se 'Azov Concord' u bë anija e parë e huaj që u largua nga porti në Mariupol - një qytet i shkatërruar nga bombardimet ruse.

# Rreth 100 mijë punonjës publikë në Maqedoninë e Veriut në grevë të përgjithshme

**Shkup, 22 qershor** - Rreth 100 mijë të punësuar në organet e administratës shtetërore në Maqedoninë e Veriut të mërkurën janë hedhur në grevë të përgjithshme për paga më të larta. Të punësuarit në të gjitha ministritë, drejtoritë, fondet, administratën gjyqësore, kadastër, spitale, në pushtetin lokal dhe organe të tjera shtetërore kërkojnë rritje të pagës prej 2 806 denarësh apo rreth 45 euro, ashtu siç ishte premtuar, sipas sindikatës, nga ana e qeverisë disa muaj më pare, se nga 1 korriku do të ketë rritje lineare të pagave.

Të punësuarit në këto organe shtetërore thonë se kriza ekonomike ka përkeqësuar gjendjen e tyre ekonomike dhe sociale, gjë që i ka detyruar të hyjnë në grevë të përgjithshme. "Konsiderojmë se një rritje e përgjithshme e pagave do të ishte shumë e rëndësishme për të gjithë të punësuarit pasi po përballemi me krizë të thellë, me vështirësi të shumta për sigurimin e një jete normale në kohën kur kemi rritje të përditshme të çmimeve", ka deklaruar Lubisha Karanfilovski, i punësuar në Qendrën Klinike Universitare në Shkup.

Greva do të jetë e përditshme nga ora 10:00 deri në orën 14:00.

Gjatë kësaj periudhe punonjësit do të jenë në vendet e tyre të punës, por nuk do të ofrojnë shërbime.




## Inflacioni në Britaninë e Madhe arrin nivelin më të lartë në katër dekada




**Londër, 22 qershor** - Norma e inflacionit të Britanisë arriti në 9.1 për qind në maj, një nivel rekord në katër dekadat e fundit. Zyra për Statistikat Kombëtare tha të mërkurën se inflacioni i çmimeve të konsumit u rrit sërish në muajin maj, niveli më i lartë që nga viti 1982.

Ekonomisti Grant Fitzner tha se "rritja e vazhdueshme e çmimeve të ushqimeve dhe çmimet e larta rekord të karburanteve u kompensuan nga kostot e veshjeve që u rritën më pak se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar".

Rritja ishte në përputhje me pritjet e analistëve dhe sinjalizon se nuk ka një fund të shpejtë të rritjes së kostos së jetesës me të cilën përballen miliona njerëz në Britani. Banka e Anglisë thotë se inflacioni mund të arrijë në 11 për qind në tetor kur të hiqet edhe kufiri në faturat e brendshme të energjisë.

Miliona njerëz në Britani, si ata në të gjithë Evropën, po përballen me rritjen e kostos së tyre të jetesës, pjesërisht të nxitura nga lufta e Rusisë në Ukrainë, e cila po kufizon furnizimet me energji dhe produkte ushqimore siç është gruri.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Qeveria merr vendim për rregullimin e çmimit të naftës

Me qëllim parësor mbrojtjen e konsumatorit, si dhe mbrojtjen e konkurrencës, pas shqyrtimit, është miratuar edhe udhëzimi administrativ për rregullimin e çmimeve të produkteve të naftës dhe karburanteve të ripërtëritshme dhe masat e tjera mbrojtëse



“Epoka e re”

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Qeveria e Kosovës ka zhvilluar të mërkurën mbledhjen e radhës në të cilën ka miratuar disa vendime. Me qëllim parësor mbrojtjen e konsumatorit, si dhe mbrojtjen e konkurrencës, pas shqyrtimit, është miratuar edhe udhëzimi administrativ për rregullimin e çmimeve të produkteve të naftës dhe karburanteve të ripërtëritshme dhe masat e tjera mbrojtëse.

Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, në arsyetimin e saj të paraqitur në mbledhjen e qeverisë, tha se “udhëzimi ka për qëllim mbrojtjen e konsumatorit, mbrojtjen e konkurrencës dhe mënjanimin e çrregullimit të tregut”.

Ministrja Hajdari në arsyetimin e saj nuk ka përcaktuar ndonjë çmim maksimal të lejuar për naftën dhe as nuk ka thënë se kur do të ndodhë kjo.

Çmimet e naftës janë rritur së fundmi në Kosovë. Aktualisht një litër naftë shitet 1.91 euro.

Ministrja Hajdari ka thënë se në bazë të të dhënave që kanë marrë nga Dogana dhe Administrata Tatimore e Kosovës është vërejtur se ka mospërputhje të çmimeve në Kosovë në krahasim me lëvizjet në tregjet botërore.

Qeveria ka miratuar vendimin me të cilin Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve bartet në Zyrën e Kryeministrit.

Miratimin nga kabineti qeveritar e ka marrë Projektligji për ratifikimin e traktatit mbi ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet penale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane.

Është miratuar edhe Rregullorja për koordinimin ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës për Deminim Humanitar.

Po ashtu, është miratuar edhe ndryshimi dhe plotësimi i vendimit të qeverisë për nominimin e përfaqësuesve të Qeverisë Republikës së Kosovës në Këshillin Konsultativ për Komunitete.

Me propozimin e Ministrisë së Arsimit, të Shkencës, të Teknologjisë dhe Inovacionit është miratuar edhe vendimi për t'i propozuar Kuvendit të Republikës së Kosovës ratifikimin e anëtarit ndërkombëtar në Këshillin Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare të Akreditimit.

Qeveria ka ndarë njëzet mijë e shtatëqind e njëzet e një euro (20,721.00) për përmbushjen e kontributit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2022 në Qendrën Rajonale të Nismës Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë me seli në Shkup.

Me qëllim të funksionalizimit të Komisionit të Ankesave për të Huaj, është miratuar ndryshimi dhe plotësimi i vendimit të qeverisë për emërimin e anëtarëve të këtij komisioni.

Qeveria ka rialokuar tre milionë euro në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për realizimin e 25 projekteve kapitale në përputhje me marrëveshjet e mirëkuptimit të nënshkruara nga ministri i MAPL, kryetarët e komunave dhe donatorët.

Po në këtë mbledhje qeveria ka aprovuar vendimin për hartimin e Planit Hapësinor të Kosovës dhe Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”, sipas propozimit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Vendimi preliminar për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të cilat gjenden brenda Lokacionit të Aeroportit të Gjakovës ka marrë miratimin e qeverisë në këtë mbledhje. Këto shpronësime bëhen për nevoja të realizimit të projekteve infrastrukturore të Ministrisë së Mbrojtjes.

Kabineti qeveritar ka miratuar edhe katër nisma për negocim të marrëveshjeve ndërkombëtare, me propozimin e Zyrës së Kryeministrit: Nisma për lidhjen e Marrëveshjes dypalëshe të bashkëpunimit për zhvillim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut; Nisma për Memorandumin e Mirëkuptimit mes Republikës së Kosovës dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut për zbatim të Marrëveshjes dypalëshe në lidhje me bashkëpunimin për zhvillim; Nisma për Amendamentin 2 të Marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2015; Nisma për amendamentin 2 të Marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2018.

Si pjesë e reformimit të sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative, u miratua konceptdokumenti për themelimin e Fondit të Konfiskimit.

Hartimi i konceptdokumentit ka për qëllim luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, përdorimin e pasurive të konfiskuara për ripërdorim shoqëror për kompensimin e viktimave të krimit dhe për ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e konfiskimit.

# Osmani në Bruksel: Mbështetja nga Parlamenti Evropian, garanci për rrugën evropiane të Kosovës




BRUKSEL, 22 QERSHOR (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, gjatë vizitës në Bruksel, ku po qëndron me ftesë të presidentit të Këshillit Evropian, Charles Michel, ka takuar presidenten e Parlamentit Evropian, Roberta Metsola.

Në takim me Metsolan, presidentja Osmani ka theksuar se Parlamenti Evropian ka shprehur qartë dhe në mënyrë të vazhdueshme vullnetin e popujve të BE-së për t'i hapur rrugë liberalizimit të vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës si dhe nevojën e përshpejtimit të perspektivës evropiane.

Për këtë si dhe për mbështetjen e vet presidentes Metsola, presidentja Osmani ka shprehur mirënjohjen e thellë të popullit dhe të institucioneve të Kosovës. “Në një diskutim të hapur dhe përmbajtjesor me presidenten e Parlamentit, Roberta Metsola në Bruksel, diskutuam për nevojën që liderët e vendeve anëtare të BE-së ta reflektojnë vullnetin e Parlamentit si dhe të jepet sinjal i qartë se vendet demokratike, liridashëse dhe të përkushtuara ndaj vlerave evropiane, e kanë vendin në BE”, ka theksuar Osmani pas takimit.

Në takimin e liderëve të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor në Bruksel presidentja Osmani do ta përçojë mesazhin e qartë të popullit të Kosovës mbi nevojën e përshpejtimit të procesit të integrimit, duke filluar nga liberalizimi i stërvonuar i vizave deri te mbështetja për statusin e vendit kandidat për Republikën e Kosovës, pas aplikimit.

Liderë të BE-së dhe të Ballkanit Perëndimor në takimin e Brukselit, ndër të tjera, do të diskutojnë për procesin e zgjerimit dhe perspektivën evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor.



# Kurti thotë nuk i ka ndryshuar qëndrimet, opozita e quan mashtrues

Kryeministri Albin Kurti të mërkurën është përballur në seancën e Kuvendit me deputetët e opozitës për marrëveshjen e arritur për energjinë me Serbinë. Deputetët e opozitës e kanë quajtur mashtrues pasi, sipas tyre, për vite të tëra Kurti të tjerët i kishte shpallur tradhtarë në raport me këtë marrëveshje. Sipas opozitës, tash, me ardhjen në pushtet, Kurti i ka ndryshuar qëndrimet. Me konstatimet e opozitës nuk është pajtuar kryeministri Kurti, duke theksuar se nuk ka ndryshuar as qëllime dhe as qëndrime, por e ka gjetur Kosovën në baltë

EPOKA E RE **Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 22 QERSHOR** - Delegacioni i Kosovës dhe ai i Serbisë kanë arritur të martën në Bruksel pajtueshmëri për zbatimin e marrëveshjes ekzistuese për energjinë. Kryenegociatori i Kosovës në dialogun me Serbinë, Besnik Bislimi, ka thënë se kjo marrëveshje mundëson faturimin e energjisë elektrike në katër komunat veriore të Kosovës sipas ligjeve dhe sistemit rregullativ të Kosovës.

Ndërkaq opozita ka drejtuar kritika në adresë të qeverisë Kurti për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Sipas opozitës, kjo marrëveshje është arritur pa e ndryshuar asnjë presje nga ajo që e kishin finalizuar më herët, në cilësinë e kryeministrit, Hashim Thaçi dhe Isa Mustafa (2013-2015), në kuadër të dialogut në Bruksel.

Opozita ka kritikuar kryeministrin Kurti për ndryshim të qëndrimeve tash pas ardhjes në pushtet.

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, e ka pyetur kryeministrin Albin Kurti pse po i ndryshon qëndrimet tani që është në pushtet.

Lidhur me marrëveshjen e nënshkruar me Serbinë për energjinë në Bruksel, Haradinaj i tha Kurtit se "këtu të kuptoj", por e luti të njëjtin që si kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje t'i kursejë deputetët nga pyetjet "pse tash", ose "pse vetëm tash po paguajnë rrymë serbët në veri". "Na kurseni se nuk jua kemi borxh. Dilema ime është kjo, pse kur të tjerët jetojnë në realitet në minimum për ta nxjerrë maksimumin para jush, është tradhti kombëtare e pse në rastin e juaj kur ndodh, kjo është e drejtë. Dhe, e kam një pyetje për fund, çka do të ndodhë me Valaqin? Pra, me stacionin?", e ka pyetur Haradinaj kryeministrin.

Kryeministri tha se qeveria e tashme i ka të përlyera duart me baltë, pasi ashtu e ka gjetur Kosovën. "Unë besoj se ka qenë dëmtim i madh i sistemit elektroenergjetik në Kosovë privatizimi i shpërndarjes dhe furnizimit. Nuk do ta kisha bërë kurrë, por tash s'kam qare pa bashkëpunuar me ta. Sepse mund të bëhet edhe shumë më keq. Në Kosovë e dini shumë mirë që keni fshatra të shndërruara në komuna për shkak të përkatësisë etnike. Ngjashëm edhe sa i përket çështjes së energjisë. E kemi të trashëguar këtë gjendje. Po e bëjmë më të mirën e mundshme. A ka qenë ndonjë marrëveshje në të kaluarën tradhti? Po, ka qenë. A i kemi duart e përlyera me baltë? Po, i kemi, sepse Kosovën e kemi gjetur në baltë, por ndërgjegjen e kemi të pastër", ka thënë Kurti, duke shtuar se nuk ka ndryshuar as qëllime dhe as qëndrime. "Unë nuk kam ndryshuar as koncept, as qëllime, as qëndrime, mirëpo kam metoda të cilat për konceptin dhe qëllimin e njëjtë bëjmë më të mirën e mundshme në kohën që është e ngopur me trashëgimi të mbrapshta", ka deklaruar Kurti.

Ndërkaq deputetja e LDK-së, Vlora Dumoshi, i ka quajtur mashtrues deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje dhe kryeministrin e vendit, Albin Kurti. Dumoshi gjatë fjalës së saj në Kuvendin e Kosovës e kritikoi pozitën për nënshkrimin e Marrëveshjes për Energjinë në mes dy shteteve Kosovë - Serbi. Ajo i pyeti nëse ndihen të turpëruar pas arritjes së marrëveshjes, duke u thënë se qeverisjet e kaluara për këto marrëveshje i kanë shpallur tradhtare. "Për kryeministrin më erdhi shumë keq. Pas tërë atyre përpjekjeve për vite e vite, u dorëzuat. Keni nënshkruar një marrëveshje për të cilën të tjerët i shpallnit tradhtarë. Do t'ju pyesja si po ju duket vetja sot? Unë nuk po ju them tradhtarë, se është fjalë e papërgjegjshme. As me vezë nuk po ju gjuaj siç vepruat ju. Por po ju quaj mashtrues e po ju pyes a turpëroheni? A jeni operu prej turpit? Ju çdo ditë po na forconi bindjen se jeni shpifës dhe mashtrues", ka thënë Dumoshi.

Pas përfundimit të fjalimit, në foltoren e Kuvendit, deputetja Dumoshi, ua dha disa vezë Kurtit, Konjfucës dhe Haxhiut, si simbolikë kundër sulmeve që këta i kanë bërë më herët në Kuvend.

Deputeti i PDK-së, Ferat Shala, gjatë seancës i ka thënë kryeministrit Kurti se qytetarëve u keni premtuar ndryshim, kurse tash po e bëni të kundërtën. "Është e pasinqertë që ju qytetarëve të Kosovës u keni premtuar ndryshim, u keni premtuar të kundërtën e asaj që dje e keni arritur në Bruksel. Mbi këtë bazë keni djegur dhe shkrumbuar shumë institucione të këtij vendi. Dje patëm një kthesë në sektorin energjetik. Dje patëm një marrëveshje të re që qeveria na e solli pas më shumë se nëntë vjetësh, të cilën Albin Kurti e pati fyer, sharë, denigruar dhe anatemuar në baza politike, partiake, deri në aspekt të tradhtisë kombëtare", ka thënë deputeti Shala.

→

# Prania e teorive konspirative, e dezinformimit dhe lajmeve të rreme pati efekte të dëmshme te perceptimi publik për pandeminë

EPOKA E RE
Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka publikuar të mërkurën raportin hulumtues "Ndikimi i dezinformimit dhe polarizimit politik gjatë pandemisë Covid-19 në Kosovë". Sipas QKSS-së, ky raport është një përpjekje për dokumentimin e rasteve të dezinformimit dhe polarizimit politik gjatë pandemisë Covid-19 në Kosovë si dhe identifikimin e implikimeve të tyre në formësimin e qëndrimeve të publikut ndaj pandemisë dhe menaxhimit të pandemisë.

Qëllimi i raportit është të shërbejë si një paralajmërim për institucionet dhe publikun e Kosovës dhe si thirrje urgjente për shqyrtimin e përpjekjeve për komunikim strategjik teksa përgatitemi për krizat e ardhshme kombëtare.

Raporti konstaton se institucionet, mediet dhe publiku nuk ishin të përgatitur për t'iu kundërvënë propagandës dhe dezinformimit që hidhnin dyshime rreth ekzistencës së Covid-19, masave mbrojtëse kundër Covid-19 dhe vaksinimit.

Në këtë drejtim, pavarësisht prej përpjekjeve të tyre për të komunikuar çdo ditë me publikun, institucionet e Kosovës nuk arritën të krijojnë një sistem komunikimi për trajtimin e lajmeve të rreme dhe për menaxhimin e një përgjigjeje efektive kombëtare për frenimin e përhapjes së informacionit të rremë - si dezinformim ashtu edhe keqinformim rreth virusit dhe pasojave të tij.

Fokusi i këtij raporti nuk është përcaktimi i marrëdhënies së drejtpërdrejtë shkak - pasojë mes polarizimit politik dhe politizimit të masave kundër Covid-19 dhe shkallës së infektimit, shkallës së vaksinimit dhe shkallës së vdekjeve, por që përmes shembujve dhe metodave të ndryshme të tregojë se mungesa e një mesazhi konsistent dhe të unifikuar, dhe hedhja e akuzave dhe kundërakuzave për menaxhimin e pandemisë që e rënduan peizazhin politik të Kosovës në vitet 2020 dhe 2021, ishin faktorë kontribuues në rezultatet e përziera të Kosovës në menaxhimin e pandemisë.

Raporti, gjithashtu, thekson se përpjekjet e medieve, që t'i ofrojnë publikut informacion të besueshëm rreth Covid-19, u sfiduan nga prania e lajmeve të rreme dhe konspiracioneve për virusin dhe pandeminë në rrjetet sociale dhe mediet e ndryshme online.

Prania e teorive konspirative, dezinformimit dhe lajmeve të rreme në rrjetet sociale në Kosovë, pati efekte të dëmshme te perceptimi publik për pandeminë si kërcënim dhe pranimin e kufizimeve institucionale për parandalimin e pandemisë.

Raporti ka identifikuar dy kategori të individëve dhe grupeve që kanë promovuar informacione të rreme për pandeminë në Kosovë. Grupi i parë përfshin ata që nuk e pranonin ekzistencën e virusit dhe përhapnin narracionin se pandemia ishte vepër e aktorëve të fuqishëm, ndërsa në grupin e dytë përfshihen ata që besojnë në ekzistencën e virusit, por nuk e pranonin kërcënimin e virusit dhe përhapnin ide kundër vaksinimit ndaj Covid-19.

Raporti më tej konstaton se këto grupe janë të ndikuar nga narrativat e lëvizjeve globale, të cilat bazohen në paragjykime antisemite në përpjekjet e tyre për




përhapje të lajmeve të rreme për ekzistencën dhe origjinën e virusit.

Brenda këtyre grupeve raporti identifikoi narrativa të ndryshme të përdorura për shpërndarje të dezinformimit. Narrativa të tilla përfshijnë teorinë konspirative se pandemia Covid-19 ishte rezultat i garës mes fuqive të mëdha për kontroll mbi ekonominë dhe informacionin botëror, duke e portretizuar Covid-19 edhe si një mjet të Perëndimit për shfarosjen e popullsinë e të ashtuquajturave vende të "Botës së Tretë" për t'i adresuar sfidat e veta të sigurisë. Sipas kësaj logjike, në versionin kosovar të kësaj nënnarrative Kosova konsiderohet si vend i "botës së tretë" dhe për këtë arsye është cak i fushatës së shpopullimit. Për më tepër, raporti konstaton se një prej narrativave dominuese ishte ideja se Covid-19 ekziston, por rreziku prej tij është i ngjashëm me viruset e tjera dhe nuk shkakton vdekje. Raporti më tutje konstaton se ata që bëjnë thirrje kundër vaksinimit janë më të shumtë në numër në krahasim me ata që nuk e pranojnë ekzistencën e virusit, prandaj një narrativë e shpeshtë që haset në Kosovë është kontestimi i procesit të licencimit të vaksinave që janë aktualisht në treg.

Gjetjet e këtij raporti theksojnë nevojën emergjente për një plan të centralizuar të komunikimit strategjik nga institucionet e Kosovës. Rrjedhimisht, bazuar në përvojën e pandemisë Covid-19 dhe mësimet e nxjerra nga shqyrtimi i mjedisit informativ të Kosovës në të cilin u zhvillua menaxhimi i pandemisë, institucionet e Kosovës duhet të zhvillojnë një strategji të qartë dhe gjithëpërfshirëse komunikimi për çështjet që kanë të bëjnë me mirëqenien e publikut, duke përfshirë kriza shëndetësore, emergjencat natyrore dhe kërcënimet e sigurisë kombëtare që siguron ndarje konkrete dhe të qarta të roleve dhe veprimeve në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Për më tepër, një strategji e tillë duhet të parashohë edhe prodhimin dhe shpërndarjen e kundër-narrativave për luftimin e dezinformimit dhe keqinformimit rreth çështjeve të shëndetit publik dhe emergjencave të tjera kritike.

Institucionet e Kosovës duhet të bëjnë analiza sistematike dhe ta demaskojnë dezinformimin rreth çështjeve të shëndetit publik, efektin e tyre në shoqëri dhe format në të cilat ato shpërndahen në mënyrë që përgjigjja ndaj tyre të jetë efektive dhe konkrete.

Në këtë drejtim komunikimi i institucioneve duhet të jetë në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe avancimin e platformave të ndryshme të komunikimit në mënyrë që shtrirja e informatave të verifikuara dhe zyrtare të përkojë me përdorimin e platformave të ndryshme online që shfrytëzohen nga qytetarët e Kosovës.

## Liberalizimi i vizave për Kosovën në margjinat e Samitit të BE-së

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Disa diplomatë të vendeve të Bashkimit Evropian vazhdojnë të thonë se vendet e tyre po bëjnë përpjekje që nga Samiti i BE-së, që do të zhvillohet më 23 dhe 24 qershor në Bruksel, të shprehet mbështetje e qartë politike për liberalizimin e vizave për Kosovën. Kjo do të shërbente pastaj si një pikënisje për procedurën, e cila do të iniciohet në grupet punuese të Këshillit, ku edhe do të merreshin vendimet.

Komisioni Evropian që nga viti 2018 ka konfirmuar se Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret dhe ka rekomanduar heqjen e vizave.

Komisioni këtë qëndrim e ka përsëritur edhe në pranverë të




këtij viti.

Edhe Parlamenti Evropian ka mbështetur dhe ka dhënë pëlqimin e vet për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Mbështetjen e Parlamentit Evropian e ka përsëritur të mërkurën edhe presidentja e Parlamentit Evropian, Roberta Metsola, pas takimit që ka pasur me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani.

Metsola ka shkruar në "Twitter" se liberalizimi i vizave duhet të ndodhë pa vonesa.

Por, çështja gjithmonë ka mbetur e bllokuar në Këshillin e BE-së.

Tash, pasi çështja është ngritur në nivelin më të lartë politik dhe liberalizimin e vizave e kanë mbështetur disa liderë të vendeve anëtare edhe publikisht, janë rritur gjasat që të nisë procedura.

Liberalizimi i vizave për Kosovën nuk ka qenë i paraparë që të jetë formalisht në agjendë, por është përmendur mundësia që të shprehet mbështetje politike.

## Largohen mbeturinat në rrugët e fshatit Karaçevë e Epërme

Kamenicë, 22 qershor (ER) - Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim në komunën e Kamenicës është angazhuar t'ua lehtësojë qytetarëve qasjen në rrugë, përkatësisht në zonat më të thella malore. Kësaj radhe kjo drejtori është angazhuar në rrugët e fshatit Karaçevë e Epërme, duke bërë largimin e mbeturinave në mënyrë që banorët të kenë qasje më të lehtë në rrugë. Po ashtu, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim është e gatshme të intervenojë kur është e nevojshme në mënyrë që qytetarët të kenë qasje sa më të lehtë në rrugë.



# Reshjet e mëdha të shiut dhe breshëri dëmtuan të mbjellat e fermerëve llapjanë

Podujevë, 22 qershor (ER) - Reshjet e mëdha të shiut dhe breshëri që ka rënë të martën në pjesë të ndryshme të komunës së Podujevës kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në plantacionet dhe të mbjellat e fermerëve llapjanë.

Fshatrat më të goditura nga moti i lig janë: Lupçi i Poshtëm dhe i Epërm, Majaci, Popova, Lluzhani, Lluga, Bellopoja etj.

Drejtori i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Fatmir Rudari, drejtori i Shërbimeve Publike, i Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Bahri Selimi, bashkë me kryetarin e komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore, Kujtim Zhitia, kanë dalë në terren për t'i parë nga afër dëmet e shkaktuara nga reshjet e fundit në fshatrat Lupç, Majac dhe Lluzhan. Ata janë njoftuar edhe nga fermerët për dëmet që u janë shkaktuar në kulturat bujqësore.

Dëmet e shkaktuara në këto fshatra përfshin pothuajse shumicën e kulturave bujqësore të mbjella.

Drejtori i Bujqësisë, Rudari, u ka bërë thirrje të gjithë fermerëve që sa më parë t'i adresojnë kërkesat e tyre në komunë për kompensim të dëmit, duke ua bashkangjitur kërkesave fotografitë e plantacioneve dhe sipërfaqen e mbjell. Ai ka premtuar që raportin e plotë të komisionit do ta dërgojë në instancat qendrore dhe do ta shfrytëzohet çdo mundësi për të kërkuar kompensimin e dëmeve të cilat u janë shkaktuar.



# Policia në Ferizaj nis aksionin 'Përdorimi i telefonit gjatë drejtimit të automjetit'




Ferizaj, 22 qershor (ER) - Policia Rajonale e Ferizajt ka nisur aksionin "Përdorimi i telefonit gjatë drejtimit të automjetit".

Ky aksion po realizohet në bashkëpunim me policët me rroba civile nga Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor dhe nga policë me uniformë nga Stacioni Policor i Ferizajt. "Një patrullë e policisë me rroba civile, në lokacione të ndryshme, identifikon shoferët të cilët shkaktojnë kundërvajtje të ndryshme në komunikacion, me theks të veçantë duke e përdorur telefonin gjatë drejtimit të automjetit dhe lajmëron patrullën policore e cila është me uniformë. Pas identifikimit të kundërvajtësit, ai ndalohet nga policia me uniformë dhe i shqiptohet gjoba kundërvajtëse sipas Ligjit të Komunikacionit Rrugor", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Ky aksion do të vazhdojë edhe në ditët në vijim dhe ka synimin t'i parandalojë aksidentet në komunikacionin rrugor.

## Zgjedhen kryetarët e fshatrave Nagac dhe Celinë të komunës së Rahovecit

Rahovec, 22 qershor (ER) - Në fshatrat Nagac dhe Celinë të komunës së Rahovecit komisioni për zgjedhjen e kryetarëve të këshillave të fshatrave, lagjeve urbane dhe vendbanimeve ka zhvilluar takimet e parapara. Në të dy lokalitetet janë zgjedhur kryetarët e këshillave të fshatrave Nagac dhe Celinë. Arian Gashi u zgjodh me shumicë votash kryetar i këshillit të fshatit Nagac dhe Muhamet Ramadani kryetar i këshillit të fshatit Celinë.

Po ashtu, u vendos edhe për përbërjen e këshillit të fshatit dhe numrit të anëtarëve.

Takimet për zgjedhjen e kryetarëve të këshillave të fshatrave, lagjeve urbane dhe vendbanimeve të komunës së Rahovecit organizohen nga anëtarët e Kuvendit Komunal Rahovec dhe Ekzekutivi Komunal.



# Kosova shënon rritje të rasteve me Covid

Sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK), në ditët e fundit është shënuar rritje e rasteve me Covid-19. Në 24 orët e fundit, pas 275 testimeve, 43 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me këtë virus




EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit, pas 275 testimeve, 43 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19 dhe nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Të mërkurën janë shëruar edhe tetë qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 225 312.

Në total numri i rasteve aktive me Covid është 154.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se Kosova shënon këto ditë rritje të rasteve të reja me Covid-19 por, fatmirësisht, nuk ka raste të vdekjeve nga kjo sëmundje.

“Në vende të ndryshme të botës po regjistrohen raste të shumta të Covid-19, sepse pandemia nuk ka mbaruar. IKShPK-ja është duke vazhduar pandërprerë testimin dhe gjurmimin e të gjitha rasteve, kontakteve të rasteve në komunitet dhe diagnostikimin laboratorik. Të gjithë personat me kokëdhembje, kollitje, dhembje fyti, vështirësi në frymëmarrje, rrjedhje hundësh, temperaturë, plogështi, humbje e shijes, rekomandohen të testohen”, ka njoftuar IKShPK-ja, duke theksuar se, me qëllim të përforcimit të imunitetit dhe parandalimit të rasteve të reja dhe formave të rënda të sëmundjes, qytetarët këshillohen të vaksinohen, me dozën e parë ata që ende s’janë vaksinuar, kurse të tjerët me dozën e dytë dhe dozën e tretë të vaksinës kundër Covid-19.

“MSh dhe IKShPK u rekomandojnë qytetarëve që, përkundër situatës së qetë dhe stabile epidemiologjike në vend, të jenë të kujdesshëm për zbatimin e masave preventive kundër sëmundjeve ngjitëse dhe të vaksinohen kundër Covid-19”, ka njoftuar IKShPK-ja.

Me qëllim të parandalimit dhe mbrojtjes nga infeksioni, Ministria e Shëndetësisë u bënë thirrje qytetarëve që nuk kanë marrë ende asnjë dozë të vaksinës kundër Covid-19, që të vaksinohen, ndërsa qytetarët që i kanë marrë një apo dy doza të vaksinës, ta marrin dozën e dytë, respektivisht dozën e tretë të vaksinës. “Imuniteti i fituar përmes vaksinimit, me kalimin e kohës vjen duke rënë, prandaj vaksinimi me dozën e radhës (doza e dytë apo e tretë) ndihmon në rindërtimin e imunitetit”, ka njoftuar MSh-ja.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë dhënë 46 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 830 243 doza të vaksinës. Deri më sot 823 608 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Po ashtu, deri më sot janë dhënë 103 094 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.

# Nënshkruhet marrëveshja për operimin e Fondit në sektorin privat

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 QERSHOR - - Gjatë pjesëmarrjes së tij në Forumin për Zhvillim të organizuar nga Fondi OPEC, ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati dhe drejtori gjeneral i Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar, Abdulhamid Alkhalifa, kanë nënshkruar marrëveshjen për operimin e Fondit në sektorin privat. Marrëveshja synon të krijojë një kornizë adekuate për funksionimin e Fondit OPEC në sektorin privat dhe ta mobilizojë financimin dhe investimet në këtë sektor.



Në këtë drejtim, ministri Murati ka theksuar se me anë të kësaj marrëveshje parashihet të mobilizohet më tutje potenciali në likuiditetin e bankave tona përmes programeve të ndarjes së rrezikut dhe ky likuiditet të drejtohet edhe në sektorin privat, veçanërisht drejt NVM-ve dhe bizneseve të grave.

Drejtori gjeneral nga Fondi OPEC ka vlerësuar nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje dhe ka theksuar përfitimet për sektorin privat, si kyç për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë së vendit. Ai ka falënderuar ministrin Murati për bashkëpunimin e theksuar dhe pjesëmarrjen e tij në forum.

Në anën e tij, drejtuesi i OPEC-ut për Sektorin Privat ka shprehur gatishmërinë e zhvillimit të mundësive të bashkëpunimit me sektorin privat në Kosovë, duke theksuar se programet e Fondit OPEC përkojnë ngushtë me nevojat e tregut kosovar.

Forumi “Qëndrueshmëria dhe Barazia Ekonomike” është Forumi i parë i Fondit OPEC për Zhvillim dhe ka për qëllim diskutimin e ndryshimeve klimatike, qasjen në energji dhe sigurinë ushqimore.

Ky forum ka mbledhur liderë qeveritarë, ministra nga vendet anëtare dhe partnere të Fondit OPEC, krerët e institucioneve të Grupit Koordinues Arab, zyrtarë të lartë të bankave zhvillimore dhe organizatave ndërkombëtare si dhe përfaqësues të sektorit privat.

## Bie mbi 5 për qind çmimi i naftës në bursë




PRISHTINË, 22 QERSHOR - Çmimi i naftës në bursën ndërkombëtare ka rënë mbi 5 për qind. Kjo ka ndodhur pasi që presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Joe Biden, ka vendosur t’i ulë kostot e karburantit në këtë shtet, raporton “Guardian”. Kjo lëvizje po shihet se do t’i përkeqësojë marrëdhëniet në mes të kreut të Shtëpisë së Bardhë dhe industrisë së naftës. Ai pritet që të bëjë thirrje për një pezullim të përkohshëm të taksës federale prej 18.4-përqindësh për galon për benzinën.

Nafta e papërpunuar Brent është duke u tregtuar sot me 109.72 dollarë për fuçi.

# Kurti për marrëveshjen për energjinë: Pas 20 vjetësh po e ndalim një gjakderdhje financiare në veri

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Kryeministri Albin Kurti në mbledhjen e qeverisë ka folur të mërkurën për marrëveshjen e arritur me Serbinë për energjinë. Ai ka thënë se pas më shumë se 20 vjetësh, buxhetit të Republikës së Kosovës do t'i kursehen dhjetëra milionë euro në vit, të paguara më herët për mbulimin e kostove energjetike të veriut të vendit. "Katër komunat në veriun e Kosovës do të kalojnë në një rend të rregullt të furnizimit, faturimit dhe inkasimit të pagesave për konsumin e energjisë elektrike në bazë të sistemit rregullativ dhe ligjor të Republikës së Kosovës", ka deklaruar Kurti.

Ai ka shtuar se udhërrëfyesi në takimin e djeshëm në Bruksel do ta mundësojë këtë. "Bashkimi Evropian do ta mbikëqyrë zbatimin e këtij pajtimi. Me zbatimin e këtij udhërrëfyesi, do të mundësohet përfundimi definitiv i një problematike të trashëguar, të pagesës së energjisë në katër komunat në veri të vendit. Kemi trashëguar shumë gjëra që nuk kemi dashur. Po bëjmë më të mirën me atë çfarë kemi trashëguar. Siç jemi zotuar, pas 20 vjetësh po e ndalim një padrejtësi dhe gjakderdhje financiare në atë pjesë të vendit dhe po përfundojmë një problematikë në sektorin e energjisë", ka thënë Kurti, duke shtuar se ky sektor është prioritar për Qeverinë e Republikës së Kosovës, pasi prek çdo aspekt të jetës së qytetarëve tanë. "Për këtë arsye ne kemi marrë përsipër detyrën e rëndësishme të zhvillimit të një Strategjie Kombëtare të Energjisë në mënyrë që sektori ynë i energjisë të niset për një tranzicion të drejtë energjetik - tranzicion i cili do ta diversifikojë miksin e energjisë, do ta ruajë sigurinë e furnizimit, do ta promovojë energjinë e pastër dhe bashkëpunimin rajonal, në radhë të parë me Shqipërinë, por edhe me vendet e tjera. Strategjia e Energjisë 2022-2031 po finalizohet përmes proceseve demokratike, transparente e gjithëpërfshirëse", ka thënë Kurti.




Kryeministri ka bërë me dije se ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, po vazhdon konsultimet publike anembanë Kosovës për draftin e Strategjisë së Energjisë si dhe shqyrtimet e vazhdueshme me profesionistë dhe ekspertë të shumtë. "Andaj shpresoj që sa më shumë qytetarë do të bashkohen në këto diskutime, që të kemi një strategji e cila u shërben më së miri të gjithëve, e një sektor të energjisë që furnizon e trajton në mënyrë të barabartë të gjithë qytetarët. Trajtimin e barabartë të të gjithë qytetarëve të Republikës sonë, në raport me konsumin dhe pagesën e energjisë elektrike, do ta mundësojë zbatimi i udhërrëfyesit djeshëm. Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar që transformimin e sektorit të energjisë ta bëjë duke siguruar drejtësi sociale. Ne do ta vazhdojmë punën për një të ardhme energjetike të Kosovës më të ndritshme, më të qëndrueshme e në shërbim të zhvillimit të shtetit tonë", ka thënë Kurti.

# AKP-ja hap shpalljen për qiradhënie të aseteve atraktive në disa komuna




PRISHTINË, 22 QERSHOR (ER)- Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka hapur shpalljen publike për qiradhënie të aseteve atraktive në disa komuna të Kosovës: Prishtinë njëmbëdhjetë asete, në rajonin e Pejës dymbëdhjetë asete, në rajonin e Prizrenit dy asete asete, në rajonin e Gjilanit pesë asete dhe tetë asete të ish-Ndërmarrjes N.Sh "Metaliku" në Gjakovë.

Shpallja publike është e hapur më 22 qershor, ndërsa dorëzimi dhe hapja e ofertave dhe publikimi i çmimeve do të bëhet më 6 korrik në zyrat rajonale respektive të AKP-së: Prishtinë, Gjilan, Pejë dhe Prizren, ndërsa për asetet e N.Sh "Metaliku" në Gjakovë në Zyrën Qendrore të AKP-së - Njësia për Monitorim, Kontroll dhe Administrim Direkt. "Periudha e qiradhënies është për një vit me mundësi vazhdimi, gjithashtu parashihet edhe ndërprerja e saj në rast të privatizimit. Ofertat mund të bëhen në mënyrë individuale për secilën njësi veç e veç dhe me zarf të mbyllur (një zarf - një ofertë për një njësi), dorëzohen në Zyrën Rajonale ku është aseti për të cilin ofertohet", thuhet në njoftimin e AKP-së.

Ndërkaq në rastet e qiradhënies në vlera mbi 1 000 euro mujore, para nënshkrimit të kontratës do të kërkohet nga ofertuesi fitues të sjellë garancinë bankare (jo letër zotimi nga banka) në lartësinë e kontratës. "Ofertat do të pranohen më 06.07.2022 prej orës 10:00 - 12:00 në zarf të mbyllur për secilën njësi veç e veç. Në zarf të mbyllur zarfet do të hapen 15 minuta pas dorëzimit, pra në orën 12:15, kurse ofertat përmes faksit ose postës elektronike nuk do të pranohen", ka njoftuar AKP-ja.

## ZRRE-ja të premten shqyrton kërkesën për dhënien e licencës për "Elektroseverin"

PRISHTINË, 22 QERSHOR (ER) - Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) pritet ta shqyrtojë kërkesën për dhënien e lejes për operim në veri të vendit kompanisë "Drustvo Elektrosever". Sipas ZRRE-së, të premten, duke filluar nga ora 13:00, nga 24 pikat që janë në rend dite, njëra prej tyre është edhe shqyrtimi i kërkesës për dhënie të licencës për furnizim me energji elektrike kompanisë serbe. "Shqyrtimi i kërkesës/aplikacionit për dhënie të licencës për Furnizim me Energji Elektrike për 'Drustvo Elektrosever D.O.O.'", thuhet në pikën e 7 të rendit të ditës.

Kosova dhe Serbia, me ndërmjetësimin e Brukselit, kanë arritur ta nënshkruajnë të martën marrëveshjen për energjinë. Marrëveshja parasheh që ZRRE-ja do t'i lëshojë licencën për furnizim "Elektroseverit". Pas kësaj, "Elektroseveri" do t'i ofrojë KEDS-it dhe KOSTT-it të dhënat më të fundit të disponueshme për konsumatorët përmes BE-së.

"ZRRE-ja do t'i lëshojë licencën për furnizim 'Elektroseverit.' ZRRE-ja do ta sigurojë zbatueshmërinë me kushtet e përcaktuara me licencën e furnizimit, në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullative të Kosovës", thuhet në pikën e parë të Udhërrëfyesit. "Brenda shtatë ditëve nga lëshimi i licencës për furnizim, 'Elektrosever' do t'u ofrojë KEDS-it dhe KOSTT-it të dhënat më të fundit të disponueshme për konsumatorët përmes BE-së", theksohet në pikën e radhës.



# Pse BE-ja duhet të zgjerohet pa humbur kohë me Ballkanin Perëndimor



Nga Christina GRIESSLER
*"Geneva Graduate Institute"*

Evropa e mori emrin e saj nga grekët e lashtë, që i referoheshin në atë kohë një territori që shtrihet në veri nga Peloponezi deri në pjesën kontinentale. Pra atë që ne sot e njohim si Ballkan. Sipas këtij këndvështrimi, rajoni i Ballkanit përbën qendrën e kontinentit evropian.

Vendndodhja gjeografike e vendeve të Ballkanit brenda kontinentit evropian është fikse, por marrëdhënia e vendeve ballkanike me Bashkimin Evropian është shumë komplekse.

Disa vende të rajonit – Kroacia, Bullgaria, Greqia, Rumania dhe Sllovenia – janë pjesë e unionit, ndërsa të tjerat janë përfshirë në një proces të gjatë me objektiv hyrjen në Klubin Evropian.

Neni 49 i Traktatit të Bashkimit Evropian, thekson se "çdo shtet evropian që respekton vlerat e unionit dhe është i përkushtuar për t'i promovuar ato, mund të aplikojë për t'u bërë anëtar". Por një vështrim i shpejtë në hartën e Evropës na tregon se përveç 6 shteteve të Ballkanit Perëndimor, Shqipërisë, Bosnje Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, të tjerët si Gjeorgjia, Ukraina, Moldavia, Bjellorusia dhe Rusia, nuk përputhen dhe aq me parakushtin territorial.

Megjithatë, shtetet evropiane duhet të përmbushin kushtet politike dhe të jenë demokraci të qëndrueshme. Për më tepër, siç po e shohim aktualisht, një zgjerim i mëtejshëm drejt pjesëve lindore të Evropës, do të krijojë tensione të mëtejshme me Rusinë.

Vendet e Ballkanit Perëndimor i përmbushin kriteret gjeografike për anëtarësim në BE, dhe janë të angazhuara të plotësojnë kushtet për të drejtat themelore, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Por pse duhet të integrohet sa më shpejt Ballkanit Perëndimor në BE?

Një vështrim mbi hartë na e jep përgjigjen. Këto vende janë të rrethuara nga vende të tjera anëtare të BE-së. Të shkosh në Greqi nga Evropa Qendrore do të thotë të kalosh nëpër vendet e Ballkanit Perëndimor. Sapo Ballkani Perëndimor të bëhet pjesë e BE-së, Bullgaria, Rumania dhe Greqia do të humbnin një kufi të jashtëm të BE-së, dhe do të fitonin fqinjë të rinj të BE-së.

Do të lehtësoheshin pengesat e bashkëpunimit ndërkufitar, transportit dhe kontaktit mes njerëzve. Kur diskutonin anëtarësimin në union, Komisioni i BE-së ka filluar të marrë në konsideratë faktorët gjeopolitikë të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Për shkak të vendndodhjes së rajonit, BE-ja ka nevojë për qasje në infrastrukturën e Ballkanit Perëndimor, që të përmirësojë ndërlidhjen e tyre në fushat e transportit, energjisë dhe telekomunikacionit. Prandaj, në kuadër të Komunitetit të Transportit, që u themelua në vitin 2017 dhe përbëhet nga anëtarët e BE-së dhe 6 shtetet e Ballkanit Perëndimor, BE-ja po siguron shumë fonde për projekte që lehtësojnë integrimin e infrastrukturës së Ballkanit Perëndimor në BE.

Nga ana tjetër, vendet e Ballkanit Perëndimor po miratojnë rregullat dhe rregulloret e BE-së në fushën e transportit. BE-ja e ka pranuar se vendet e Ballkanit Perëndimor janë fqinjët e tyre, dhe se meqenëse kufijtë janë artificialë, tejkalimi i tyre është një objektiv.

BE-ja nuk mund ta shohë veten si një njësi të izoluar, që është në gjendje të kujdeset për veten e saj. Ky fakt bëhet veçanërisht i dukshëm në lidhje me çështjet e sigurisë. Pas shpërbërjes së Jugosllavisë në fillim të viteve 1990, përvoja e luftës në kontinent ishte tronditëse për Evropën.

Në atë kohë Evropa, nuk ishte e përgatitur për t'u marrë në mënyrën e duhur me këtë çështje. Ekzistonte frika se luftërat mund të përhapeshin në vendet fqinje, duke krijuar një ndjenjë pasigurie. Që herët, KE dhe më vonë BE-ja kërkuan që vendet në rajon të krijojnë një dialog politik midis tyre dhe të bashkëpunojnë për çështje specifike për të rivendosur besimin e humbur.

Për të nxitur stabilitetin, vendeve të ish-Jugosllavisë dhe Shqipërisë, iu premtua se do të përfshiheshin në familjen evropiane. Tani me vonesën e zgjerimit të BE-së, dhe paraqitjen në rajon të aktorëve të tjerë të huaj, siguria ka qenë subjekt i vëmendjes së përtërirë nga ana e Brukselit.

Kjo u pa me fluksin e madh të emigrantëve në vitin 2015, që kërkoi nga BE-ja të bashkëpunonte ngushtë me vendet në kufirin e saj jugor për të menaxhuar fluksin e njerëzve që shkonin drejt Evropës Qendrore dhe Perëndimore. Pra u bë një detyrë e jo-anëtarëve të BE-së që të mbyllnin qasjen në "fortesën" Evropë në emër të BE-së.

Bashkimi Evropian është ende partneri më i madh tregtar i Ballkanit Perëndimor. Edhe pse vendet e Ballkanit Perëndimor formojnë një grupim të vogël, me struktura të fragmentuara ekonomike, tregje të vogla dhe një fuqi blerëse në përgjithësi të ulët, disa anëtarë të BE-së kanë interes të rrisin investimet e tyre dhe të zgjerojnë mundësitë e biznesit në rajon. Ndërlidhja ekonomike e vendeve evropiane në të gjithë kontinentin evropian, është e dukshme. Megjithatë për shkak të madhësisë së tij, tregu i BE-së i tërheq më pranë vetes edhe ekonomitë e tjera më të vogla, madje duke i vendosur ato në një gjendje varësie. Për të qenë ekonomikisht të qëndrueshme, ekonomitë duhet të krijojnë marrëdhënie tregtare me BE-në. Vendet në fqinjësi të BE-së ose kanë negociuar pasjen e një qasjeje dypalëshe në tregjet e BE-së, ose po përpiqen të përmbushin kriteret për anëtarësimin në BE për të qenë në gjendje të gëzojnë përfitimet e saj. Idetë për një integrim të pjesshëm të ekonomive në tregun e BE-së, tregojnë edhe një herë se sa vendet, veçanërisht ato fqinje, janë tashmë të ndërlidhura dhe të lidhura ekonomikisht me njëra-tjetrën.

Njerëzit janë një tjetër arsye, se përse ka kuptim zgjerimi i BE-së në këtë rajon. Sipas të dhënave të vitit 2021, popullsia totale e 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor arrin në rreth 17.7 milionë njerëz. Pranimi i vendeve në një union të përbashkët ka kuptim, kur kihet parasysh fakti se shumë njerëz nga Ballkani Perëndimor jetojnë tashmë në vendet e BE-së dhe janë thelbësorë për ekonomitë e vendeve pritëse.

Nga perandoritë që ndanë Evropën, autokracitë, demokracitë, gjenocidet, shtypjet, vrasjet, dhe luftërat, Evropa ka përjetuar gjithçka. Pas Luftës së Dytë Botërore, kur Gjermania dhe Franca u bashkuan për të ndërtuar një marrëdhënie miqësore, u mboll fara e një Bashkimi Evropian që synonte të kapërcejë mizoritë e kaluara dhe të vendosë mirëqenien e popullit të tij në qendër.

Nëse besojmë ende në idenë kryesore të BE-së, nuk duhet vënë në dyshim, përkundrazi duhet inkurajuar pranimi i të gjitha vendeve evropiane në union. BE-ja nuk duhet të krijojë barriera apo pengesa të reja, por duhet të mbështesë tejkalimin e tyre. Edhe pse për momentin mund të ketë disa probleme praktike me zgjerimin e BE-së, është e rëndësishme të mos humbasim tablonë më të gjerë dhe të punojmë drejt arritjes së përmbushjes së vizioneve të BE-së.

**Marrë me shkurtime**

Shënim: Christina Griessler, studiuese në Rrjetin për Komunikim Politik (netPOL) dhe drejtuese e Politikave Krahasuese me fokus Evropën Qendrore dhe Lindore në BE, Universiteti Andrassy në Budapest, Hungari.




# Sport

QENDRA SPORTIVE
‘BUJQËSIA’
TEL: 045/82 82 82

# Kosova, nikoqire e Kupës së Botës për Universitete




**Prishtinë, 22 qershor** - Prej 11 deri më 17 korrik Kosova do të jetë mikpritëse e Kupës së Botës në Hendboll për Universitete. 20 universitete do të marrin pjesë në këtë ngjarje madhështore. Ky kampionat do të zhvillohet në Pallatin e Rinisë dhe në sallën “1 Tetori” në Prishtinë dhe është duke u cilësuar si një organizim i jashtëzakonshëm pasi në Kosovë do të zbarkojnë vende nga katër kontinente të botës. Me këtë rast, ushtruesi i detyrës i kryetarit të Federatës së Sporteve Universitare e Kosovës, Gani Ibrahimi, që është nikoqir i këtij kampionati, ka thënë se organizimi i kësaj ngjarjeje kaq të madhe është privilegj dhe përgjegjësi.

“Me të drejtë thuhet se ngjarjet e mëdha sportive janë martesa e sportit me kulturën. Këto janë agjenda shtetërore jo vetëm sportive, ngritje flamujsh universitetesh, krahas universiteteve e kulturave botërore. Pas shtatë vjetësh anëtarësim në Komitetin Olimpik të Federatës së Sporteve Universitare të Kosovës në FISU dhe EUSA, Kosova ndihet krenare me sukseset e arritura brenda një kohe të cilat kanë krijuar një bonus të mjaftueshëm. Edhe më shumë se njëherë sot duhet të ndihemi të privilegjuar dhe të përgjegjshëm për besimin e dhënë nga FISU për organizimin e Kampionatit Botëror për Universitete Botërore. Të ecim së bashku në këtë rrugëtim të ri, të prezantojmë vlerat dhe kulturat sportive, të prezantojmë kulturë universitare në regjion dhe rajone ndërkombëtare”, ka thënë Ibrahimi.

Ndërsa ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ka thënë se organizimi i kësaj ngjarjeje është një mundësi e artë për t’i treguar vlerat tona. Ai ka bërë me dije se ministri janë shumë afër arritjes së një marrëveshjeje për organizimin e një tjetër ngjarjeje të madhe sportive vitin e ardhshëm. “Nga momenti i parë ne kemi qenë shumë jo vetëm të gatshëm, por edhe të motivuar nga ideja që shteti ynë të jetë mikpritës i një ngjarjeje kaq të rëndësishme ndërkombëtare të sportit dhe këtë të gjithë së bashku duhet ta shohim si mundësi të artë për shtetin tonë jo vetëm si një moment që ndodh sivjet gjatë korrikut, por edhe si argument i fuqishëm që Kosova është e gatshme me të gjitha kapacitetet për të pritur ngjarje të mëdha ndërkombëtare duke nisur me Kampionatin Botëror Universitar në Hendboll. Jemi duke negociuar dhe jemi shumë afër për ta siguruar edhe një ngjarjeje shumë të rëndësishme ndërkombëtare të sportit për vitin e ardhshëm. Jam shpresëplotë që shumë shpejt do ta publikojmë edhe atë dhe në përgjithësi të vazhdojmë t’i tregojmë të gjithë botës që shteti ynë konkurron me shumë vlera”, ka thënë Çeku.

Në anën tjetër, kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë se kjo ngjarje tregon se “jemi të gatshëm për organizime të mëdha ndërkombëtare”. “Nëpërmjet sportit po e zhvillojmë edhe turizmin sportiv, ku po e reprezantojmë edhe kulturën dhe traditën tonë, ku po bëjmë ndërlidhje të shumta në mes të Kosovës dhe vendeve të tjera të botës”, ka thënë Rama.



# Hapet rruga e Aro Muricit drejt Burnleyt

**Burnley, 22 qershor** - Newcastle Unitedi është duke bërë çmos për të nënshkruar me Nick Popen. Portieri i skuadrës së Burnleyt, Nick Pope, është dëshira e skuadrës më të pasur në botën e futbollit aktualisht. Eddie Howe e dëshiron portierin në skuadër dhe marrëveshja është shumë afër, kanë bërë me dije mediet angleze. Kësisoj, me një marrëveshje afër finalizimit mes Popes dhe Newcastles, rruga për Arijanet Muriçin duket e hapur. Aro Muriç pritet të transferohet te Burnley, ku tashmë trajner është Vincent Kompany. Kompany, dikur kapiten i Man Cityt, e kishte shok skuadre për disa kohë portierin e Kosovës. Belgu e pëlqen shumë portierin Aro Muriç dhe dëshiron ta ketë në skuadër. Transferimi i Popes te Newcastle do t’i hapte rrugë Aros për kompletimin e transferimit.

## Sadio Mane bëhet lojtar i Bayernit

**Bayern, 22 qershor** - Tashmë është gjithçka zyrtare. Sadio Mane është futbollisti më i ri i Bayern Munichut. Sulmuesi 30-vjeçar ka nënshkruar kontratë me kampionët gjermanë deri më 30 qershor të vitit 2025. Lajmi është bërë me dije nga të dy ekipet, Liverpooli dhe Bayerni.

Pas zyrtarizimit, Sadio Mane ka dhënë një deklaratë të shkurtër për faqen zyrtare të klubit gjerman. “Jam shumë i lumtur që më në fund jam me FC Bayern në Munih. Kam vërtet ndjenja të mëdha, kështu që nuk kisha asnjë dyshim në mendjen time që në fillim. Kjo është koha e duhur për këtë sfidë”, ka thënë Mane.

Mane ka zhvilluar 269 ndeshje për Liverpoolin, duke shënuar 120 gola dhe 38 asiste.



**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

**Kuvendi i Republikës së Kosovës, rishpall:**

**K O N K U R S**
**Për zgjedhjen e 1 (një) anëtari në Këshillin Gjyqësor të Kosovës**

Në pajtim me nenin 10 të Ligjit nr. 06/L -055 për Këshillin Gjyqësor të Republikës Kosovës dhe me qëllim të përmbushjes së obligimit kushtetues dhe ligjor për zgjedhjen e anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës,

**Kuvendi rishpall konkurs për plotësimin e pozitës:**

1 (një) anëtar/e në Këshillin Gjyqësor, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Kandidati për anëtar në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës, përveç kushteve të përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligjin për Këshillin Gjyqësor, duhet t'i plotësojë edhe këto kushte:

1. Kandidati që nuk ushtron funksionin e gjyqtarit, duhet të ketë së paku 5 (pesë) vite përvojë pune profesionale dhe duhet të ketë njohuri për funksionimin e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës;
2. Të ketë integritet të lartë moral;
3. Të mos jetë i dënuar për vepër penale në Kosovë;
4. Të mos ketë ushtruar ndonjë funksion politik në 3 (tri) vitet e fundit; ( për kandidatët që nuk ushtrojnë funksionin e gjyqtarit ).

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Autobiografia (Curriculum vitae);
- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale ( për kandidatët që nuk ushtrojnë funksionin e avokatit apo gjyqtarit );
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale.

**PROCEDURA E KONKURRIMIT**

**Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 12 korrik 2022, në orën 16:00.**

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:
Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtoria e Personelit, Zyra N-217).

**Aplikacionet mund të merren në këto vende**:

*Forma e shtypur*: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose
*Forma elektronike*: faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org
Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 211-182, 038 211-648 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara.
Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Skupština Republike Kosovo ponovo objavljuje:**

**K O N K U R S**
**Za izbor 1 (jednog) člana u Sudskom savetu Kosova**

U skladu sa članom 10. Zakona br. 06/L-055 o Sudskom savetu Republike Kosovo i u cilju ispunjenja ustavne i zakonske obaveze za izbor članova Sudskog saveta Republike Kosovo,

**Skupština ponovo objavljuje konkurs za popunjavanje radnog mesta:**

1. (jedan) član Sudskog saveta, kako je definisano članom 108. stav 6. tačka 4. Ustava Republike Kosovo.

Kandidat za člana Sudskog saveta Republike Kosovo, pored uslova utvrđenih Ustavom i zakonom o Sudskom savetu, treba da ispunjava i sledeće uslove:

1. Kandidat koji ne obavlja funkciju sudije, treba imati najmanje 5. (pet) godina radnog iskustva u struci i mora imati znanje o funkcionisanju pravosudnog sistema Republike Kosovo;
2. Treba imati visoki moralni integritet;
3. Da nije osuđivan za krivično delo na Kosovu;
4. Da nije obavljao nikakvu političku funkciju u poslednje 3. (tri) godine; (za kandidate koji ne obavljaju funkciju sudije).

Uz prijavu moraju biti priložena sledeća prateća dokumenta:

- Autobiografija (Curriculum vitae);
- Dokaz o školskoj i stručnoj spremi (za kandidate koji ne obavljaju funkciju advokata ili sudije);
- Dokaz da je državljanin Republike Kosovo;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Dokaz da nije osuđivan za krivično delo.

**PROCEDURA KONKURISANJA**

**Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 12. jul 2022. godine u 16.00 časova.**

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu:
Zgrada Skupštine Republike Kosovo, Priština (Ul. „Majka Tereza" bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

**Aplikaciju možete uzeti u:**

*Štampanoj formi:* na recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosovo, Priština, ul."Majka Tereza" bb. ili u
*Elektronskoj formi:* internet–stranica Skupštine Republike Kosovo - www.assembly-kosova.org
Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana do 16.00 časova, na brojeve telefona: 038 211-182, 038 211-648 i 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz zahtevana dokumenta.
Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažećim.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT/MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS
AGJENCIA SHTETERORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS/DRZAVNA AGENCIJA ARHIVA KOSOVA/ STATE AGENCY OF KOSOVO ARCHIVES

## KONKURS PUBLIK PËR DIZAJNIMIN E LOGOS SË AGJENCISË SHTETËRORE TË ARKIVAVE TË KOSOVËS

Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës shpall konkurs publik për dizajnimin e Logos së institucionit - Agjencisë Shtetërore të Arkivave së Kosovës (AShAK), themeluar me vendimin Nr. 17000 të datës 20 mars 1951 nga Kuvendi i Kosovës.

Vlerësimi i propozimeve do të bëhet nga një komision profesional i themeluar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës.

**Kriteret e dizajnimit të logos:**

- Të jetë origjinale, unike dhe të mos jetë imitim i ndonjë logoje ekzistuese.
- Të ketë pasqyrim artistik të veprimtarisë së Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës;
- Të shpreh funksionin dhe mandatin e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës;
- Të jetë e veçantë, kreative, kualitative, profesionale dhe prezantuese;
- Të jetë dinjitoze për identitetin e Institucionit përgjegjës për administrimin dhe ruajtjen e pasurisë arkivore në vend;
- Të jetë lehtësisht e kuptueshme;
- Të përçojë mesazh të qartë;
- Të jetë e dallueshme, t'i rezistojë kohës dhe të jetë e lehtë për tu mbajtur në mend;
- Të jetë e përshtatshme për vendosje në dokumente fizike dhe në paraqitje elektronike, e lehtë për shtyp, në sfonde të bardha dhe të erreta;
- Të jetë lehtë e përdorshme në madhësi të ndryshme;
- Të ketë shpjegim të secilit detaj të propozuar në logo

**Mënyra e aplikimit:**

Logoja duhet të dorëzohet në pliko të mbyllura me shifër dhe pa emër të autorit në CD, (në të kundërtën do të skualifikohet), bashkë me një version vektor të logos dhe po ashtu e shtypur në kopje fizike.

Dosja e aplikimit duhet të përmbajë një manual të shpjegimeve të përmbajtjes dhe përdorimit.
Aplikacioni duhet të ketë mbishkrimin "Për dizajnin ideor të Logos së ASHAK-së"
Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht ose me postë, në adresën e mëposhtme:

**Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës, Zyra e Prokurimit, Nr. 10**
**Adresa: Rr. „Arbnor e Astrit Dehari" nr.25 | 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës**

Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë artistët nga Kosova, rajoni dhe bota.

Konkursi është i natyrës garuese dhe ideja më e mirë e përzgjedhur do të shpërblehet me 3,000€.

Të drejtat e autorit për propozimet e përzgjedhura barten nga propozuesi tek ASHAK.

Data e fundit e aplikimit është 15.8.2022.

---

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "kasolla34" Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për objektet e 30 kasollave që do të ndërtohen në zonën kadastrale Baraianë, Podujevës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 22.07.2022 në ora 10:00 në hapësirat e restorant "Adriatik" Batllavë, komuna e Podujevës, do të organizohet debat publik nga Kompania "kasolla34" Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për objektet e 30 kasolleve që do të ndërtohen në zonën kadastrale Baraianë, Podujevës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

https://zoom.us/j/95803739388?pwd=MUc2MGI4ZnlMQWtQM1pOYTFaWTZ1Zz09

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "kasolla34" Sh.p.k. Prishtinë për objektet e 30 kasollave që do të ndërtohen në zonën kadastrale Baraianë, Podujevës.

https:// mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publikimet/279/publikimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

---

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ "Verë Ndimën" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810859746 adresa Kodra e Diellit, Prishtinë.

▶ Fatmir Hoti shpall të pavlefshme certifikatën Ndertimtari-Ferizaj, 16.01.2009-nr. 1114/1.

▶ "Poliklinika Gjinolli" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 310457433.

▶ Drita Kameri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Bujqësi.

▶ Gzim Qarkagjija nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SHM. Teknike "Nexhmedin Nixha" Makineri

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në përputhje të Aktgjykimit nr. Ref AGJ. 1583/20 në rastin nr. KO203/19 të Gjykatës Kushtetuese datë 09 Korrik 2020, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës Nr.06/L-055, nenit 39 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-054 Për Gjykatat, Nenit 9 Rregullore Nr. 04/2021 Për Procedurën e Rekrutimit dhe Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional dhe Vendimit KGJK-së Nr. 248/2022 të datës 31 maj 2022, shpall:

# KONKURS PUBLIK
## PËR POZITËN BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL NË GJYKATAT REPUBLIKËS SE KOSOVËS

**NUMRI I POZITAVE TË SHPALLURA: - 82 pozita**

| Nr. rendor | Gjyakata / dega | Pozita | Nurmi i pozitave të lira | Te rezervuara per komunitet serb |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme | Bashkëpunëtor profesional | 1 | |
| 2 | Gjykata e Apelit | Bashkëpunëtor profesional | 20 | 2 - Gjykatën e Apelit Prishtinë |
| 4 | Gjykata Themelore - Prishtinë | Bashkëpunëtor profesional | 22 | 1 |
| 5 | GjThP/ Dega-Podujevë | Bashkëpunëtor profesional | 2 | |
| 6 | GjThP/ Dega-Gracanice | Bashkëpunëtor profesional | 1 | 1 |
| 7 | Gjykata Themelore - Prizren | Bashkëpunëtor profesional | 5 | |
| 8 | Gjykata Themelore - Gjilan | Bashkëpunëtor profesional | 5 | 1 |
| 9 | Gjykata Themelore - Ferizaj | Bashkëpunëtor profesional | 4 | |
| 10 | GjThF/ Dega-Kacanik | Bashkëpunëtor profesional | 2 | |
| 11 | GjThF/ Dega-Shterrpce | Bashkëpunëtor profesional | 1 | |
| 12 | Gjykata Themelore - Pejë | Bashkëpunëtor profesional | 2 | |
| 13 | GjThP/ Dega-Istog | Bashkëpunëtor profesional | 1 | |
| 14 | Gjykata Themelore - Gjakovë | Bashkëpunëtor profesional | 4 | |
| 15 | Gjykata Themelore - Mitrovicë | Bashkëpunëtor profesional | 10 | 7 |
| 16 | GjThM/ Dega-Leposavic | Bashkëpunëtor profesional | 1 | 1 |
| 17 | GjThM- Dega - Zubin Potok | Bashkëpunëtor profesional | 1 | |
| | | TOTALI | 82 | 13 |

**PËRSHKRIMI I DETYRAVE TË PUNËS:**

**Titulli i pozitës së punës:** ***Bashkëpunëtor profesional;***

**Kategoria Funksionale:** *niveli profesional*
**Grada e Vendit të Punës:/ Koeficienti:** *Koeficienti - 9*
**Lloji i Vendit të Punës:** *pa afat të caktuar, me orar të plotë*
**Departamenti/Divizioni/Njësia:** *Zyra për Mbështetje Juridike në Gjykatë / zyra e Ndihmës administratorit në degë*
**Raporton tek:** *i përgjigjet dhe i raporton Udhëheqësit të Zyrës dhe gjyqtarit me të cilin punon në Gjykatë / gjyqtarit me të cilin punon dhe Gjyqtarit Mbikëqyrës në degë*
**Vlerësimi i performancës:** *nga Udhëheqësi i Zyrës në koordinim me gjyqtarin me të cilin punon/ gjyqtarin me të cilin punon dhe Gjyqtari Mbikëqyrës në degë*
**Vendndodhja:** *Gjykatë /degë përkatëse*
**Procedura e aplikimit:** Konkurs i Jashtëm sipas Vendimit KGJK-së Nr. 248/2022
**Kohëzgjatja e kontratës së punës:** *Kontratë pune me afat të pacaktuar – përfshi periudhën provuese 6 muaj*
**Arsyeja e rekrutimit:** *plotësim i pozitave të lira sipas organogramit dhe planifikimit të punësimit për vitin 2022*

**Qëllimi i vendit të punës**: *(përshkrim i shkurtër i qëllimit të pozitës dhe çka duhet të arrijë kjo pozitë)*

Zyrtar me kompetence profesionale që i ofron mbështetje profesionale gjyqtarit, ndihmon në përgatitjen e memorandumeve, vendimeve të shkruara, aktgjykimeve, vendimeve të tjera, duke siguruar materiale të domosdoshme juridike dhe duke bërë shqyrtimin e ligjeve.

**Detyrat Kryesore:** *(përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore, të renditura për nga rëndësia dhe një përshkrim të përqindjes së kohës, e cila duhet të shpenzohet për secilën detyrë)*

- Me kërkesën e gjyqtarit me të cilin punon bënë përgatitjen e vendimeve gjyqësore (aktgjykime, vendime, urdhëresa dhe shkresa tjera) sipas udhëzimit të gjyqtarit;..........................................20%
- Përmes detyrave të caktuara nga gjyqtari me të cilin punon, bashkëpunëtori profesional kryen hulumtime ligjore, përpilimin e vendimeve gjyqësore;.............................................................20%
- Prezanton në seanca gjyqësore duke marrë shënime dhe duke siguruar materiale të domosdoshme juridike;.....................................................................................................................10%
- Bën hulumtime në shqyrtimin e ligjeve dhe praktikave gjyqësore të dobishme për çështje të ndryshme;..................................................................................................................10%
- Kryen të gjitha detyrat e zyrtarit ligjor në rastet e mungesës së tyre dhe detyra tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë dhe gjyqtarit me të cilin punon;……………......…20 %
- Kryen të gjitha detyrat dhe veprimet me lëndën që i caktohen nga gjyqtari me të cilin punon përfshirë dhe të gjitha veprimet në SMIL;...............................................................................10%
- Kryen edhe detyra tjera sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga mbikëqyrësi i dretëpërdrejtë dhe përgatitë raportet javore të punës...............................................................................................10%

**Përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe vlerësimit të performancës:** *(cilat pozita i raportojnë kësaj pozite dhe cilave pozita ju bënë vlerësim performance kjo pozitë, nëse ka)*

- ***Nuk ka***

**Niveli i përgjegjësisë financiare:** *(p.sh. buxheti për të cilin është përgjegjëse pozita përkatëse, niveli i autorizimit për shpenzime)*

- ***Nuk ka***

**Shkathtësitë e kërkuara:** *(aftësitë dhe shkathtësitë që kërkohen për ketë vend pune)*

- Të ketë njohuri profesionale në fushën e legjislacionit dhe akteve ligjore juridike....E nevojshme;
- Të ketë shkathtesi të deshmuara ndër personale per komunikim publik.....................E nevojshme;
- Të ketë shkathtesi hulumtuese, analitike, vleresuese dhe formulim te rekomandimeve dhe këshillave profesionale.............................................................................................E nevojshme;
- Të ketë aftesi të shkrimit dhe arsyetimit ligjor............................................................E nevojshme;
- Të ketë njohuri për sistemin dhe procedurat gjyqësore;.............................................E nevojshme;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel,)...................E nevojshme;

**Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës**: *(kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)*

- Diplomë universitare të vlefshme në Kosovë: Fakulteti Juridik.................................E nevojshme;
- Provimi i Jurisprudencës i vlefshëm në Kosovë.........................................................E nevojshme;
- Minimum tri (3) vite përvojë pune juridike për Gjykatën Supreme, Gjykatën e Apelit dhe në Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale si dhe minimum dy (2) vite përvojë pune juridike për Gjykatat Themelore dhe degë e tyre dhe Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale......E nevojshme;

**Karakteristikat e pazakonta të mjedisit të punës nëse ka:** *(p.sh. rreziqet e jashtëzakonshme në vendin e punës, presionet fizike ose rreziqet nga ekspozimi ndaj substancave të rrezikshme ose përdorimi i pajisjeve që paraqesin rrezik dhe të cilat rezultojnë nga natyra e vendit të punës ose vendndodhja e vendit të punës)*

- **Nuk ka**

**DOKUMENTET E NEVOJSHME**

1. Kandidatët në pajtim me nenin 10 Rregulloren Nr. 04/2021 Për Procedurën e Rekrutimit dhe Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional, duhet të dorëzojnë dokumentet si në vijim:

   **1.1.** Aplikacionin e plotësuar me të dhënat e kërkuara;
   **1.2.** Çertifikatën e shtetësisë së Republikës së Kosovës;
   **1.3.** Diplomën e Fakultetit Juridik të vlefshme në Republikën e Kosovës;
   **1.4.** Çertifikatën e provimit të jurisprudencës, të pranuar sipas ligjit të aplikueshëm në Republikën
   **1.5.** Dëshminë mbi përvojën e punës në fushën juridike, të përcaktuar me këtë rregullore dhe legjislacionin ne fuqi;
   **1.6.** Çertifikata shëndetësore për vlerësimin e aftësive psiko-fizike të kandidatit; si dhe
   **1.7.** Çertifikatën nga evidenca penale, e lëshuar nga gjykata;

2. Kandidati mund të dorëzojë edhe dokumentacionet si në vijim:

   **2.1.** Publikime profesionale apo akademike; dhe/ose
   **2.2.** Informata për pjesëmarrje në trajnime.

**NJOFTIM I RËNDËSISHËM PËR KANDIDATËT**

I. Neni 10 paragrafi 5 Rregulloren Nr. 04/2021 Për Procedurën e Rekrutimit dhe Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional, përcakton se procesit të rekrutimit kanë të drejtë t'i nënshtrohen vetëm kandidatët e regjistruar në Këshill, në afatin e paraparë me konkurs për aplikim dhe dokumentacion të kompletuar. Ndërsa, kandidatët të cilët nuk kanë aplikuar brenda afatit të paraparë në konkurs, si dhe ata të cilët kanë aplikuar në afat, por nuk e kanë dorëzuar dokumentacionin e kompletuar sipas kritereve dhe kërkesave të konkursit nuk do të merren parasysh.

**FORMULARI I APLIKIMIT**

- formulari mund të shkarkohet nga faqja zyrtare e KGJK-së. (**www.gjyqesori-rks.org;**)
- **Shkarko aplikacionin:**

**MËNYRA E APLIKIMIT**

Aplikacioni së bashku me dokumentet mbështetëse mund të dorëzohet në Këshill në formë fizike, përmes postës së rregullt ose postës elektronike: **KGJK.BurimetNjerzore@gjyqesori-rks.org;** i cili regjistrohet dhe secili kandidat pajiset me një konfirmim mbi pranimin e aplikacionit.

**AFATI I DORËZIMIT TË APLIKACIONEVE**

Afati për dorëzimin e aplikacionit është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga publikimi i konkursit, gjegjësisht deri me datën **07.07.2022**

- **Sekretariati i KGJK-së,**
- **Rruga ''Luan Haradinaj'' nr. 133, Prishtinë, në Zyrën e Pranimit.**
- **10000 Republika e Kosovës**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Sudski savet Kosova, u skladu sa članom 108. Ustava Republike Kosovo, Zakonom o Sudskom savetu Kosova br. 06 / L-055, Zakonom o sudovima br. 06 / L-054, u skladu sa presudom br. Ref AGJ. 1583/20, u predmetu br. KO203/19, Ustavnog suda, Pravilnika (04/2021) i Odluke SSK br. 248/2022 od 31. maja 2022. godine, raspisuje:

## JAVNI KONKURS
### ZA POZICIJU STRUČNI SARADNIK U OSNOVNIM SUDOVIMA REDPUBLIKE KOSOVA

Broj objavljenih pozicija: osamdesetdva (82)

| Redni broj | Sud / ogranak | Pozicija | Broj slobodnih pozicija | Rezervisane za srpsku zajednicu |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Posebna komora Vrhovnog suda | Stručni saradnik | 1 | |
| 2 | Apelacioni sud | Stručni saradnik | 20 | 2 - Apelacioni sud u Pristini |
| 4 | Osnovni sud - Pristina | Stručni saradnik | 22 | 1 |
| 5 | OSP/ Ogranak-Podujevo | Stručni saradnik | 2 | |
| 6 | GjThP/ Dega-Gracanice | Stručni saradnik | 1 | 1 |
| 7 | Osnovni sud - Prizren | Stručni saradnik | 5 | |
| 8 | Osnovni sud - Gjilan | Stručni saradnik | 5 | 1 |
| 9 | Osnovni sud - Ferizaj | Stručni saradnik | 4 | |
| 10 | OSU/ Ogranak-Kacanik | Stručni saradnik | 2 | |
| 11 | OSU/ Ogranak-Strpce | Stručni saradnik | 1 | |
| 12 | Osnovni sud - Pec | Stručni saradnik | 2 | |
| 13 | OSP/ Ogranak-Istok | Stručni saradnik | 1 | |
| 14 | Osnovni sud- Djakovica | Stručni saradnik | 4 | |
| 15 | Osnovni sud - Mitrovica | Stručni saradnik | 10 | 7 |
| 16 | OSM/ Ogranak-Leposavic | Stručni saradnik | 1 | 1 |
| 17 | OSM- Ogranak- Zubin Potok | Stručni saradnik | 1 | |
| | | TOTAL | 82 | 13 |

**OPIS RADNIH DUŽNOSTI:**

**Naziv radnog mesta:** ***Stručni saradnik ;***

**Funkcionalna kategorija:** *profesionalni nivo,*
**Stepen radnog mesta:/ Koeficijent:** *koeficijent devet (9)*
**Vrsta radnog mesta:** *neodređeno vreme, sa punim radnim vremenom,*
**Departman /Odsek/Jedinica:** *Kancelarija za pravnu podršku u sudu /kancelarija pomoćnika administratora u ogrankama*
**Izveštava:** *odgovara i izveštava rukovodiocu kancelarije i sudiji s kojim radi u sudu/sudiji s kojim radi i nadzornog sudiji u ogranku*
**Ocenjivanje radnog učinka:** *Rukovodilac kancelarije i sudije s kojim radi/ sudija s kojim radi i nadzornog sudiji u ogranku*
**Lokacija;** *Dotični sud/ ogranci*
**Prostupak apliciranja:** Javni konkurs Odluke SSK. 248/2022
**Trajanje ugovora o radu:** *Ugovor o radu na neodređeno vreme- uključujući probni period od 6. meseci*
**Razlog regrutacije:** *popunjavanje slobodnih pozicija na osnovu organizacione šeme i planiranja za zaposlenje za 2022. godinu*

**Cilj radnog mesta:** *(kratak opis svrhe pozicije i šta ova pozicija treba da postigne)*

Stručno osposobljeno službeno lice koje pruža stručnu podršku sudiji, pomaže u pripremi memoranduma, pismenih odluka, presuda, drugih odluka, obezbeđujući potreban pravni materijal i razmatranje zakona.

**Glavne dužnosti :** *(kratak opis glavnih dužnosti raspoređeno po važnosti i opis procenta vremena koje treba potrošiti na svaku dužnost)*

- Na zahtev sudije sa kojim radi, priprema sudske odluke (presude, rešenja, naredbe i druge dopise) po uputstvu sudije;.....20%
- Preko zadataka koje mu dodeli sudija sa kojim radi, stručni saradnik vrši pravna istraživanja, sačinjava sudske odluke…………20%
- Prisustvuje u sudskim raspravama uzimajući beleške i obezbeđuje neophodne pravne materijale;…………10%
- Vrši istrage na razmatranju zakona i sudskih praksi korisno za razna pitanja; ……………10%
- Obavlja sve dužnosti pravnog službenika u slučajevima njegovog odsustva i druge poslove na zahtev neposrednog rukovodioca i sudije sa kojim radi;……………..20%
- Obavlja sve dužnosti i radnje s predmetom koji se određuje od strane sudije s kojim radi uključujući i sve radnje u ISUP; ……………......10%
- Obavlja i druge poslove u skladu sa važećim zakonodavstvom i normativnim aktima usvojenim od strane Saveta koje može opravdano zahtevati neposredni rukovodilac i priprema nedeljne izveštaje o radu……………......10%

**Odgovornosti o nadzoru i ocenjivanju radnog učinka:** *(koje pozicije odgovaraju ovoj poziciji i kojim pozicijama obavlja ocenjivanje radnog učinka ova pozicija, ako ima)*

- ***Nema***

**Nivo finansijske odgovornosti :** *(npr.budžet za koju je odgovorna dotična pozicija, nivo ovlašćenja za rashode)*

- ***Nema***

**Potrebne veštine:** (*potrebne veštine i sposobnosti za ovo radno mesto*)

- Imati stručno znanje iz oblasti zakonodavstva i pravnih zakonskih akata………. Potrebno;
- Imati dokazane međusobne veštine za javnu komunikaciju ……………. Potrebno;
- Imati istraživačke, analitičke, vrednujuće veštine i formulisanje profesionalnih preporuka i saveta …………… Potrebno;
- Imati sposobnost pisanja i pravno obrazloženje …………… Potrebno;
- Imati znanje o sistemu i sudskim postupcima……………. Potrebno;
- Poznavanje rada na računaru softverskih aplikacija (Word, Excel,).....Potrebno;

**Obrazovne i stručne kvalifikacije i radno iskustvo:** *(potrebna kvalifikacija i iskustvo za ovo radno mesto)*

- Važeća univerzitetska diploma na Kosovu: Pravni fakultet ...... Potrebno;
- Pravosudni ispit koji važi na Kosovu...... Potrebno;
- Najmanje tri (3) godine pravnog radnog iskustva za Vrhovni sud, Apelacioni sud i Drugostepenog veća Privrednog suda , kao i najmanje dve (2) godine pravnog iskustva za Osnovne sudove i njihove ogranke i veća Prvostepenenog veća Privrednog suda...... Potrebno;

**Neuobičajene karakteristike radne sredine ako postoje:** *(npr. ekstremne opasnosti na radnom mestu, fizički pritisak ili opasnosti od izlaganja opasnim materijama ili upotrebe opasne opreme koje proizilaze iz prirode radnog mesta ili lokacije radnog mesta).*

- **Nema**

**POTREBNI DOKUMENTI I NAČIN PODNOŠENJA PRIJAVE**

Kandidati, u skladu sa Pravilnikom 04/2021 o postupku regrutovanje i izbora stručnih saradnika, treba da dostave sledeća dokumenta:

1.1. Popunjenu prijavu sa zatraženim podacima;
1.2. Uverenje o državljanstvu Republike Kosova;
1.3. Važeću diplomu Pravnog fakulteta Republike Kosova;
1.4. Potvrdu o pravosudnom ispitu, priznat na osnovu važećeg zakona u Republici Kosova;
1.5. Dokaz o radnom iskustvu u pravnoj oblasti, kao što je utvrđeno ovim pravilnikom i zakonodavstvom na snazi;
1.5. Zdravstveno uverenje za procenu psiho-fizičkih sposobnosti; kao i,
1.6. Potvrdu iz kaznene evidencije izdate iz suda.

2. Kandidati mogu da dostave i sledeću dokumentaciju:

2.1. Stručne i akademske publikacije; i/ili
2.2. Informacije za pohađanje obuka.

Prijava za zapošljavanje zajedno sa pratećom dokumentacijom može se podneti Savetu u fizičkom obliku, putem redovne pošte ili elektronske pošte, koja se registruje i svaki kandidat dobija potvrdu o prijemu prijave za zapošljavanje

**VAŽNO OBAVEŠTENJE ZA KANDIDATE**

Član 10. stav 5. Pravilnika 04/2021 utvrđuje da postupku regrutacije imaju pravo da podlegnu samo kandidati registrovani u Savetu, u roku predviđen konkursom za prijavu i uz kompletnu dokumentaciju. Dok kandidati koji se nisu prijavili u roku predviđen konkursom, kao i oni koji su se prijavili u roku, a nisu dostavili kompletnu dokumentaciju prema kriterijumima i uslovima konkursa, neće biti uzeti u obzir.

**OBRAZAC ZA PRIJAVU**

- obrazac se može preuzeti sa zvanične stranice SSK-a. (www.gjyqesori-rks.org)

Preuzmi prijavu

Podnošenje prijave elektronskim putem se vrši slanjem dokumentacije (prijave i prateća dokumenta) na elektronskoj adresi: KGJK.BurimetNjerzore@gjyqesori-rks.org;

**ROK ZA PODNOŠENJE PRIJAVE**

Rok za podnošenje prijave je petnaest (15) dana od dana raspisivanja konkursa, odnosno do dana **07.07.2022**

- **Sekretarijat SSK-a,**
- **Ulica ''Luan Haradinaj'' br. 133, Priština, u Kancelariji za prijem.**
- **10000 Republika Kosova**


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
RC cola
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues